


SUVA MBUSHËSE



PREMIX

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	Thes, 25 Kg	1.2 m2/thes

PËRSHKRIM

Suva mbushëse me bazë çimento-gëlqere për mure të brendshme, tavane dhe fasada. I përshtatshëm për të gjitha tipet e bazamenteve si: mur tulle, mure me blloqe betoni, gur ranorë dhe gëlqerorë. Nuk është i përshtatshëm për bazamente me lagështi të vazhdueshme. I krahasuar me llaçin tradicional redukton 25% të sasisë në aplikim.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret mbi të gjitha tipet e bazamenteve, tulla të kuqe, tulla me vrimë, tulla me porozitet të lartë, gurë, etj. Shtresë dorë e parë për mbushjen e tavaneve, mureve të brendshme dhe të jashtme, larje dorë e dytë për të eliminuar plasaritjet. Për tulla silikate me porozitet të lartë përpara aplikimit të llaçit kalohet astar akrilik i holluar 1 me 2 me ujë për të eliminuar pluhurat. Në sipërfaqet me beton rekomandohet aplikimi i beton primer i holluar 10-20%.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike. Bazamentet e përbëra, që do të thotë ku ka edhe pjesë elektrike dhe mure tulle, duhet të sprucohen fillimisht me sprucuesin Dekoll. Fugat e tullave duhet të mbyllen paraprakisht për të pasur një mbulim pa plasaritje.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Produkti është i përshtatshëm për t'u punuar me dorë dhe makineri. Përzieni me një përzierës mekanik ose me makineri 5.5-6 litra ujë me një thes 25 kg PREMIX derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza.

APLIKIMI

Aplikoni me mallën e duhur produktin e përgatitur dhe bëni nivelimin me mastar. Pas tharjes është e nevojshme që përpara vendosjes së finos të bëhet ashpërsimi i sipërfaqes së suvasë. Temperaturat optimale të punimit janë nga +5°C deri në 35°C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e punueshmërisë së produktit: 2 orë
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Densiteti i llaçit të thatë: 1.5-1.6 gr/cm ³
Ngjyra: Gri	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Kokrrizimi: 1.2 mm	Sasia e ujit: 5.5-6 litër ujë / 25 kg produkt
Konsumi: 1.2 m ² /thes/1.5 cm trashësi	Aplikimi i materialit: Me dorë ose makineri, 1-2 duar
Magazinimi: Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri	Koha e pritjes për dorën e dytë: 24 orë
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca e shtypjes pas 28 ditësh: ≥ 3.5 N/mm ²
Trashësia min e aplikimit për mure: Deri në 10mm	Rezistenca në ngjeshje: ≥0.5 N /mm ²
Trashësia min e aplikimit për tavane: Deri në 7-8mm	Absorbimi i ujit: WO
Konduktiviteti termik: 0.61 W/mK	Reaksioni ndaj zjarrit: Class A1

